



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 614/1 prot.

Tiranë më 27.02.2026

Lënda: Mendim mbi protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për ndryshimet në Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për bashkëpunim në luftën kundër krimit

**MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 897 prot., datë 25.02.2026, administruar me tonën me nr. 614 prot. datë 26.02.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim *“Protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për ndryshimet në Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për bashkëpunim në luftën kundër krimit”* të nënshkruar më 23 maj 2003, shoqëruar me materialin përkatës, Zyra e Komisionerit e vlerëson protokollin të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**